

A new commercial company is founded in Tirana, Albania, today on 05.07.2026. The founder, at the same time the sole shareholder of the company, decided to organize it in conformity with the provisions of the Albanian legislation and the following statute: STATUTE OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY "Creative Hub"	Një shoqëri e re tregtare themelohet në Tiranë, Shqipëri, sot më 05.07.2026. Themeluesi, njëherazi ortak i vetëm i shoqërisë, vendosi ta organizojë atë në përputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar në fuqi dhe këtij statuti: STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "Creative Hub"
Article 1 Company's Shareholders The company is owned by the sole shareholder: Mr. Mouala SULAIMAN, Syrian citizen, no. pass. N02802080, born on 10.01.1986.	Neni 1 Ortakët e shoqërisë Shoqëria zotërohet nga ortak i vetëm: Z. Mouala SULAIMAN, shtetas Sirian, nr. Pasaporte N02802080, lindur më 10.01.1986.
Article 2 Legal Capacity 1. The company "Creative Hub" L.L.C., hereunder referred to as the company, acquires its legal capacity at the moment of its registration at the National Business Centre (NBC). 2. The company is an foreign entity which acts in conformity with the Law No. 9901, date 14.04.2008 "For Merchants and Commercial Companies" – as amended as well as with this Statute.	Neni 2 Personaliteti juridik 1. Shoqëria "Creative Hub" SH.P.K., nga këtu e më poshtë referuar si shoqëria, e fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). 2. Shoqëria është person juridik i huaj e cila zhvillon aktivitetin në përputhje me ligjin nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" – i ndryshuar dhe këtë Statut.
Article 3 The object of the activity The company's object of activity is: - Providing advertising and marketing services, visual identity and branding design, graphic design services, management of advertising and marketing campaigns, digital marketing and social media management, production of promotional and media content, website design and development, printing and promotional materials services, organization of promotional events and exhibitions, and consultancy services in marketing, advertising, and brand development. The company may also carry out any other lawful commercial, financial, auxiliary or related activity, in accordance with the legislation in force.	Neni 3 Objekti i veprimtarisë Objekti i aktivitetit të shoqërisë është: - Ofrimi i shërbimeve të reklamimit dhe marketingut; krijimi dhe zhvillimi i identitetit vizual dhe markës tregtare; ofrimi i shërbimeve të dizajnit grafik; menaxhimi i fushatave publicitare dhe të marketingut; marketing digjital dhe menaxhim i rrjeteve sociale; prodhimi i materialeve promovuese, mediatike dhe audiovizive; projektimi, zhvillimi dhe mirëmbajtja e faqeve të internetit; shërbime printimi dhe realizimi i materialeve promocionale; organizimi i eventeve promovuese, panairove dhe ekspozitave; si dhe ofrimi i shërbimeve të konsulencës në fushën e marketingut, reklamimit, komunikimit dhe zhvillimit të markës. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu çdo veprimtari tjetër të ligjshme, tregtare, financiare, ndihmëse ose të lidhur me objektin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Creative Hub

Article 4 Seat of the Company 1. The Company has its residence/seat at the address: "Rruga Nikolla Lena, Nd. 61, H. 34, Tirana, Albania. 2. The Company may expand its activity throughout the territory of the Republic of Albania. It may establish its branches or representative offices within or outside the territory of the Republic of Albania. 3. The Residency of the Company may be transferred anywhere within the territory of the Republic of Albania, based on a decision of the Company's General Assembly.	Neni 4 Selia e shoqërisë 1. Shoqëria ka selinë e saj në adresën: "Rruga Nikolla Lena, Nd. 61, H. 34, Tirane, Shqiperi. 2. Shoqëria mundet të shtrijë aktivitetin e vetë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo mundet të themelojë degë, ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë tij. 3. Selia e shoqërisë mundet të transferohet kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë.
Article 5 Duration of the Company's activity 1. The duration of the company's activity is undetermined. 2. The change of the abovementioned term is set only by decision of the Company's General Assembly.	Neni 5 Kohëzgjatja e shoqërisë 1. Periudha e aktivitetit të shoqërisë është e papërcaktuar. 2. Çdo ndryshim në lidhje me periudhën e aktivitetit mundet të bëhet vetëm nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, me vendim.
Article 6 The data to be included in the correspondence and other documents of the company All the requisitions, order forms or any other correspondence document issued by the company, its branches or representative offices, in writing or by use of electronic means, addressed to third parties, shall contain the following data: a) The identification unique number; b) the legal status (form) of the company; c) the address of the registered office and its headquarters; d) information in case the company is in liquidation; e) If the company has its own website, the abovementioned data shall be reflected in it.	Neni 6 Të dhënat në korrespondencat dhe dokumentet e tjera të veprimtarisë së shoqërisë Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme: a) numrin unik të identifikimit; b) formën ligjore të shoqërisë; c) vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj; d) të dhëna nëse shoqëria është në likuidim. e) Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.
Article 7 Share Capital 1. The initial capital of the company is ALL 1,000 (one thousand Lek). 2. The capital is composed by 1 (one) share that is owned by the sole shareholder.	Neni 7 Kapitali Themeltar 1. Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 1,000 (një mijë Lekë). 2. Kapitali themeltar përbëhet nga 1 (një) pjesë/kuotë e cila zotërohet nga ortaku i vetëm.

Article 8 Transfer of shares The capital shares can be freely transferable between shareholders and non-shareholders.	Neni 8 Transferimi i kuotave Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe jo-ortakëve.
Article 9 Company's structure The direction and administration of the company is conducted through its bodies that are: • The Administrator. • The General Assembly.	Neni 9 Organet e shoqërisë Drejtimi dhe administrimi i shoqërisë bëhet nëpërmjet organeve të saj që janë: • Administratori. • Asambleja e Përgjithshme.
Article 10 The Administrator The Company may have one or more administrators. First administrator of the company will be Mr. Igli ZEPISHTA, Albanian citizen, holder of the Albanian ID with Personal no. G60712132V.	Neni 10 Administratori Administrator i shoqërisë mund të jetë një ose më shumë persona. Administrator i parë i shoqërisë, do të jetë Z. Igli ZEPISHTA, shtetas me nënshtetësi Shqiptare, mbajtës i kartës së identitetit shqiptare me nr. Personal G60712132V.
Article 11 Nomination of the administrator 1. The administrator is nominated by decision of General Assembly. 2. The Administrator is a natural person who might be chosen even among those who are not shareholders of the company.	Neni 11 Emërimi i administratorit 1. Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. 2. Administratori është person fizik i cili mund të zgjidhet edhe jashtë bashkësisë së ortakëve të shoqërisë.
Article 12 The duration of the mandate of the administrator 1. The act of appointment of the administrator shall define also the term in office. If this period is not defined in the letter of appointment, in any case, it may not be longer than 5 years, beginning from the appointment date. The term may be renewed after the termination of the mandate. 2. In case of withdrawal/dismissal, the General Assembly appoints the new Administrator of the Company by decision, no later than 2 weeks from the date of withdrawal's or dismissal's notice.	Neni 12 Kohëzgjatja e mandatit të administratorit 1. Akti për emërimin e administratorit përcakton gjithashtu dhe kohën e qëndrimit në detyrë të tij. Nëse kjo nuk është e përcaktuar në aktin e emërimit, kjo periudhë nuk mundet të jetë më e gjatë se 5 vjet, duke filluar ky afat nga data e emërimit. Mandati i administratorit është i rinovueshëm pas mbarimit të tij. 2. Në rast dorëheqjeje/shkarkimi nga detyra, Asambleja e Përgjithshme emëron me vendim Administratorin e ri të shoqërisë, jo më vonë se 2 javë nga data e njoftimit të dorëheqjes apo shkarkimit.

Article 13 Dismissal of the Administrator 1. Administrator is dismissed for reasonable causes, by a decision of the General Assembly. 2. Shall be considered reasonable causes all the actions performed by Administrator's fault, his incompetence in performing his functions correctly, the apparent non-enforcement of the General Assembly's decisions, non-abiding to the provisions of the Law on Trade Companies and Statute of the company, and in general terms every act taken by the Administrator, which seriously affects or may affect the interests of the company.	Neni 13 Shkarkimi i Administratorit 1. Administratori shkarkohet për shkaqe të përligjura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. 2. Do të konsiderohen shkaqe të përligjura të gjitha veprimet me faj të rëndë të Administratorit, paaftësia e tij në kryerjen korrekte të funksioneve, moszbatimi hapur i vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, mosrespektimi i dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare dhe Statutit të shoqërisë, në përgjithësi çdo veprim i Administratorit i cili dëmton ose mund të dëmtojë rëndë interesin e shoqërisë.
Article 14 The Administrator 's Competencies 1. The Administrator has full competences to act in any circumstance in the name of the company, acting always within the limits of the company's object, being bound on the competencies that the Law or this Statute, attributes to the General Assembly. 2. The Company's administrator has the following rights and obligations: a) Represents the company in relationships with third parties; b) Performs all the administrative acts of the company's trade activity, implementing the market policy imposed by the General Assembly; c) Attends the correct and regular maintenance of the documents and accounting books of the Company; d) Prepares and signs the annual balance (balance-sheet), the consolidated balance a report on the progress of the activity, and together with the proposals for the distribution of profits, he submits these documents to the General Assembly for approval; e) Sets a warning system in due time, concerning the circumstances that threaten the progress of the activity and the existence of the Company; f) Registers and sends the necessary data of the company, as stipulated by the Law on National Centre of Registration. g) Reports to the General Assembly on the implementation of the market (trades) policy, and with the special acts of high importance to the activity of the trade's company.	Neni 14 Kompetencat e Administratorit 1. Administratori në mënyrë individuale, ka kompetenca të plota për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë, gjithmonë brenda objektit të aktivitetit të shoqërisë, duke u kufizuar në ato kompetenca që ligji ose ky Statut ia jep shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme. 2. Administratori i shoqërisë ka këto të drejta dhe detyrime: a) përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët; b) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë; duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme; c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; d) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim; e) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; f) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit; g) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare. 3. Shitja dhe/ose blerja e pasurive të paluajtshme

3. The sale and/or purchase of real estates shall be considered as valid if a preliminary approval by the General Assembly of Shareholders is taken. In this case the decision is valid if the shareholder/s that represent/s at least 51 % of the company's capital, vote/s in favor of such a sale and/or purchase of a real estate. 4. The Administrator is responsible for preservation and administration of the company documents, including the decisions and the minutes of the Assembly.	do të konsiderohet e vlefshme nëse për të është marrë pëlqimi paraprak i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Në këtë rast vendimi përkatës i Asamblesë do të konsiderohet i vlefshëm, nëse ortakët që përfaqësojnë të paktën 51% të kapitalit të shoqërisë, kanë votuar në favor të shitjes dhe/ose blerjes së pasurisë në fjalë. 4. Administratori përgjigjet për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve të shoqërisë, duke përfshirë vendimet dhe procesverbalet e Asamblesë së Përgjithshme.
Article 15 The General Assembly 1. General Assembly is the supreme decision-making body of the Company. 2. General Assembly is responsible for decision making on company's behalf, on the following issues: a) defining the commercial policies of the company; b) modifications of the statute; c) appointment and dismissal of administrators; d) appointment and dismissal of liquidators and authorized accounting experts; e) determination of bonuses /remunerations/ for the persons mentioned in letters "c" and "d" of this paragraph; f) surveillance on the implementation of commercial policy by the administrators, including preparation of annual financial reviews and reports on the progress of the activity; g) approval of financial reviews and reports on the activity situation; h) increase and decrease of capital; i) shares division and their invalidation; j) company's representation in Court and in other proceedings against the administrators; k) reorganization and dissolution of the company; l) approval of procedural regulations of Assembly meetings; m) closeout of company's real estate; n) purchase of company's real estate; o) other issues prescribed by law or statute. 3. General Assembly decides on issues foreseen by letters "g" and "h" of paragraph 1 to this article, following the reception and examination of the respective documentation.	Neni 15 Asambleja e Përgjithshme 1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë. 2. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet e mëposhtme: a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; b) ndryshimet e statutit; c) emërimin e shkarkimin e administratorëve; d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike; f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures se veprimtarisë; g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë; h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit; i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre; j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë; l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë; m) shitjen e pasurive të paluajtshme të shoqërisë; n) blerjen e pasurive të paluajtshme të shoqërisë; o) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti. 3. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "g" dhe "h" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

Article 16 Meeting of the General Assembly - General Assembly is convened on the occasions foreseen by law or provisions of this statute and any time a meeting is necessary to protect the interests of the company. The ordinary meeting of the company is called for, at least once a year. - General Assembly is summoned by the administrator/s or liquidator/s. - Apart from what was stipulated in the abovementioned paragraph, shareholders who represent at least 5% of the total voting of the General Assembly of the company, or a smaller part foreseen in the statute, may address a written request, including electronic mail, with the administrators, in order to convene the General Assembly and /or include specific issues in the agenda. The request shall contain the reasons, targets and issues, upon which General Assembly will have to decide. If the request is refused, these shareholders have the right to convoke the Assembly and set the agenda, respecting the rules set by law and this statute, on the Assembly convocations by the administrator. - If, contrary to paragraph 2 of this Article, the General Assembly is not convoked or the issue requested by them is not included in the agenda, each of the shareholders who has submitted the request, has the right to: - proceed in Court, to declare the breach of the obligation to loyalty, if administrators do not fulfill the requests of the shareholders within 15 days; - ask the purchase of shares in their possession, by the company. - In cases the agenda is modified in accordance with the provisions of this article and the convocation has been communicated to the shareholders, the administrators announce again the agenda, modified, in accord with prescriptions of article 20 of the Statute.	Neni 16 Thirrja e Mbledhjes së Asamblesë - Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. - Mbledhja e asamblesë thirret nga administratori ose likuiduesi/t. - Pavarësisht nga sa përcaktohet në paragrafin e mësipërm, ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, duke respektuar rregullat që ligji dhe ky statut parashikon edhe për thirrjen e asamblesë nga Administratori. - Nëse, në kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme nuk thirret ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës secili prej ortakëve që kanë bërë kërkesën ka të drejtë: - të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve; - t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre. - Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e nenit 20 të Statutit.
Article 17 Forms of Notification The General Assembly is convoked through a written notification or a notification sent by electronic mail. The written notification or electronic message shall contain the place, date, time of meeting and the agenda and shall	Neni 17 Mënyra e njoftimit Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, e t'u

be sent to all the shareholders, no later than 7 days before the date set for the meeting of the Assembly. Attached to the written notification, shall also be included the documentation related with the agenda of the meeting. 2. If the General Assembly has not been convoked according to paragraph 1 of this Article, its decisions may be valid only if all the shareholders agree to render decisions, apart from the irregularity.	dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Bashkë me njoftimin ortakëve u duhet dërguar edhe dokumentacioni që ka lidhje me rendin e ditës. 2. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
Article 18 Representation of a shareholder 1. A shareholder may be represented at the General Assembly, by another shareholder or a third person, in base of an authorization. 2. The administrators of the company cannot act like shareholders' representatives at the General Assembly. 3. The authorization may be issued only for one meeting of the General Assembly, which also includes the consecutive meetings on the same agenda.	Neni 18 Përfaqësimi i një ortaku 1. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi, nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. 2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme. 3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
Article 19 The voting right 1. Every share gives the right to one vote. 2. Shareholders who are not present may participate at the General Assembly's meeting by making use of different communication means, including electronic ones, provided that the identity of shareholders is guaranteed. 3. Electronic means include, but are not limited only in the following: a) the direct transitions of the General Company Meeting; b) the direct mutual communication, which enables shareholders to express themselves on the meeting of the General Assembly, from a different site; c) mechanisms, which enable the voting process, before or during the meeting of the General Assembly, without the need of an authorized representative to physically be present during the meeting. 4. The use of electronic means, in order to enable the participation of shareholders in the meeting of General Assembly, is carried out as long as due technical arrangements are made to guarantee the identification of the shareholders and the security of electronic communications, so far as this use is proportionate to the	Neni 19 E drejta e votës 1. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. 2. Ortakët që nuk janë të pranishëm mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike. 3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to: a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale; b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër; c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje. 4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të

achievements of these targets .	jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.
Article 20 Exclusion from the right to vote 1. The shareholder cannot exercise his right to vote if the General Assembly decides on: a) the assessment of his activity; b) cancellation of an obligation on his behalf; c) suing him on behalf of the company; d) granting or not the new profits. 2. When the shareholder is represented by an authorized representative, the authorized is deemed to be at the same conflicting interest, as (with) the shareholder, he is representing.	Neni 20 Përfshirimi nga e drejta e votës 1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për: a) vlerësimin e veprimtarisë së tij; b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja. 2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.
Article 21 Records of the Assembly's meeting 1. All the decisions of the General Assembly shall be recorded in the minutes of the meeting. 2. The minute shall contain the date and place of the meeting, the agenda, name of the chairperson and of the minute keeper, as well as the voting results. 3. The chairperson may be one the shareholders, or the person who convoked the meeting, whereas the minute keeper is selected from the chairperson. 4. The list of participants as well as the announcement to convene the General Assembly shall be attached to this minute. 5. The minute of the meeting is signed by the chairman and the minute keeper. 6. If the company releases a web page, the administrators shall, no later than 15 days from the date of the meeting, publish a copy of the minute of the General Assembly's meeting in it.	Neni 21 Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë 1. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. 2. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryesuesit të mbledhjes dhe të mbajtësit të procesverbalit, si dhe rezultatet e votimit. 3. Kryesues i mbledhjes mund të jetë njëri prej ortakëve ose personi që ka thirrur mbledhjen, ndërsa mbajtësi i procesverbalit (sekretari) zgjidhet nga kryesuesi i mbledhjes. 4. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. 5. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. 6. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.
Article 22 The Quorum 1. In the case of rendering decisions, that require a simple majority of votes, General Assembly may take valid decisions only if the shareholders with the right to vote, who own more than 30 per cent of the shares, participate. 2. In cases General Assembly has to decide on	Neni 22 Kuorumi 1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

achievements of these targets .	jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.
Article 20 Exclusion from the right to vote 1. The shareholder cannot exercise his right to vote if the General Assembly decides on: a) the assessment of his activity; b) cancellation of an obligation on his behalf; c) suing him on behalf of the company; d) granting or not the new profits. 2. When the shareholder is represented by an authorized representative, the authorized is deemed to be at the same conflicting interest, as (with) the shareholder, he is representing.	Neni 20 Përfjashtimi nga e drejta e votës 1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për: a) vlerësimin e veprimtarisë së tij; b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja. 2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.
Article 21 Records of the Assembly's meeting 1. All the decisions of the General Assembly shall be recorded in the minutes of the meeting. 2. The minute shall contain the date and place of the meeting, the agenda, name of the chairperson and of the minute keeper, as well as the voting results. 3. The chairperson may be one the shareholders, or the person who convoked the meeting, whereas the minute keeper is selected from the chairperson. 4. The list of participants as well as the announcement to convene the General Assembly shall be attached to this minute. 5. The minute of the meeting is signed by the chairman and the minute keeper. 6. If the company releases a web page, the administrators shall, no later than 15 days from the date of the meeting, publish a copy of the minute of the General Assembly's meeting in it.	Neni 21 Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë 1. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. 2. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryesuesit të mbledhjes dhe të mbajtësit të procesverbalit, si dhe rezultatet e votimit. 3. Kryesues i mbledhjes mund të jetë njëri prej ortakëve ose personi që ka thirrur mbledhjen, ndërsa mbajtësi i procesverbalit (sekretari) zgjidhet nga kryesuesi i mbledhjes. 4. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. 5. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. 6. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.
Article 22 The Quorum 1. In the case of rendering decisions, that require a simple majority of votes, General Assembly may take valid decisions only if the shareholders with the right to vote, who own more than 30 per cent of the shares, participate. 2. In cases General Assembly has to decide on	Neni 22 Kuorumi 1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

issues, requiring a qualified majority of votes, according to Article 23 of this Statute, its decision are valid only if the shareholders who own more than half of the total number of votes are personally present, voting by written form or electronically. 3. If General Assembly cannot convene because of the absence of the quorum mentioned in parag.1 & 2 of this article, the Assembly is convened again, not later than 30 days, with the same agenda.	2. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 23 të këtij Statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike. 3. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 e 2 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
Article 23 Decision making 1. The General Assembly decides by three quarters of the votes of the participating shareholders, on the modification of the Statute, the enlargement or reduction of the registered capital, the close out of the company real estates, distribution of profits, reorganization and dissolution of the company. 2. Regarding other issues listed in article 15 of this Statute, the General Assembly decides on plurality of votes, of all the participating shareholders, except otherwise specified in this statute.	Neni 23 Marrja e vendimeve 1. Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shitjen e pasurive të paluajtshme të shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. 2. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 15 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë statut.
Article 24 Modalities and increase of the capital 1. The principal is increased through emission of new shares or through the increase of the prim value of the existing shares. 2. The new shares are paid off in cash, through compensation of a mature credit obligatory for the company, through incorporation of reserves, profits and prims of emission, through contribution in nature, etc. 3. In cases of contribution in nature, their estimation is made by one or more experts for contributions determined by decision of the Court, following a request submitted by the company Administrator. 4. The contributions expert/experts' report is made available to the shareholders at the company's Headquarters.	Neni 24 Modalitetet e zmadhimit të kapitalit 1. Kapitali themeltar zmadhohet nëpërmjet emetimit të kuotave të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të kuotave ekzistuese. 2. Kuotat e reja shlyhen me para në dorë, me kompensim të një kredie në para të kërkueshme dhe të detyruar për t'u shlyer nga shoqëria, me përfshirje të rezervave, fitimeve apo primeve të emetimit, me kontribut në natyrë etj. 3. Në rastin e kontributeve në natyrë, vlerësimi i tyre bëhet prej një ose më shumë ekspertëve për kontributet të caktuar me vendim nga gjykata, në bazë të kërkesës së bërë nga Administratori i shoqërisë. 4. Raporti i ekspertit/ekspertëve të kontributeve vihet në dispozicion të ortakëve në selinë e shoqërisë.
Article 25 Modalities on the decrease of the capital 1. The decrease in capital affects the	Neni 25 Modalitetet e zvogëlimit të kapitalit 1. Zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën

shareholders in the same proportion of the value of shares they own. 2. The capital decrease project is announced to the authorized accounting experts, at least 45 days before the meeting of the General Assembly, convened to decide on this project. 3. The Assembly decides on the report of authorized accounting experts, who give their estimation on reasons and conditions of the capital decrease.	masë në përpjesëtim me vlerën e kuotave që zotërojnë. 2. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, të paktën 45 ditë përpara mbledhjes së asamblesë së ortakëve që thirret për të vendosur mbi këtë projekt. 3. Asambleja merr vendim mbi raportin e ekspertëve kontabël të autorizuar, të cilët japin vlerësimin e tyre mbi shkaqet dhe kushtet e zvogëlimit.
Article 26 Inspection carried out by authorized accounting experts The financial inspection on the company is carried out by the authorized accounting expert.	Neni 26 Ushtrimi i kontrollit nga ekspertët kontabël të autorizuar Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga një ekspert kontabël i autorizuar.
Article 27 The mandate duration and the replacement 1. The authorized accounting experts are appointed for a period of one financial year. Their functions loose effect after the company meeting, deciding on annual accounts. 2. The authorized accounting expert, nominated by the General Assembly to replace another, remains in office up to the termination of his predecessor's mandate.	Neni 27 Kohëzgjatja e mandatit dhe zëvendësimi 1. Ekspertët kontabël të autorizuar emërohen për një vit financiar. Funksionet e tyre përfundojnë pas mbledhjes së asamblesë e cila merr vendim mbi llogaritë vjetore. 2. Eksperti kontabël i autorizuar, i emëruar nga asambleja për zëvendësimin e një tjetri, mbetet në funksion deri në fundin e mandatit të paraardhësit të tij.
Article 28 Liability of the accounting expert 1. The authorized accounting experts, are responsible to the company and to the third parties, for the harmful consequences resulting from their faults and their negligence in the fulfillment of their duties. 2. They are not considered legally liable for law violations committed by the Administrator, except the cases when they have been informed and have not disclosed this information on the Assembly meeting's report.	Neni 28 Përgjegjësia e ekspertëve 1. Ekspertët kontabël të autorizuar janë përgjegjës si ndaj shoqërisë, ashtu dhe ndaj të tretëve për pasojat e dëmshme që rrjedhin nga fajet dhe nënvleftësimet e tyre në ushtrimin e funksioneve përkatëse. 2. Ata nuk janë ligjërisht përgjegjës për shkeljet e ligjit të kryera nga Administratori, me përjashtim të rasteve kur kanë pasur dijeni për to, por nuk i kanë zbuluar në raportin për mbledhjen e asamblesë.
Article 29 Distribution of the Company's profits 1. Shareholders have the right to share the profits	Neni 29 Shpërndarja e fitimeve të shoqërisë 1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit

declared in the financial review of the company. 2. The profit is shared to the shareholders in proportion to the shares they own.	të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. 2. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.
Article 30 The limits of sharing, the certificate of solvency 1. The company may share its profits to the shareholders, only if after the payment of the dividend: a) the company assets fully cover its obligations; b) the company owns sufficient liquid assets to settle the obligations matured within the following 2 months. 2. Administrators issue a solvency certificate, which confirms expressively that the proposed distribution of dividends satisfies the requirements of parag. 1 to this Article, whilst in case the financial situation of the company reveals that it does not meet those criteria, the administrators cannot issue this certificate. 3. The Administrators are responsible to the company for the solvency certificate veracity.	Neni 30 Kufizimet e shpërndarjeve, certifikata e aftësisë paguese 1. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit: a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj; b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim. 2. Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë. 3. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.
Article 31 Company's dissolution The company will be dissolved: a) by Assembly's decision; b) with the beginning of the bankruptcy/liquidation procedures; c) if provided by law in force. d) by Court's decision.	Neni 31 Prishja e shoqërisë Shoqëria do priset: a) me vendim të asamblesë së përgjithshme; b) me hapjen e procedurave të falimentimit/likuidimit; c) nëse parashikohet nga ligji në fuqi; d) me vendim të gjykatës.
Article 32 Liquidation of the company The Liquidation process of the company shall be realized according to the conditions and procedures specified in the respective legal provisions.	Neni 32 Likuidimi i shoqërisë Likuidimi i shoqërisë kryhet në përputhje dhe në respektim të kushteve dhe procedurave të parashikuara nga dispozitat përkatëse ligjore.
Article 33 Legal base All the disputes, not foreseen or regulated specifically by this Statute, will be settled according to the provisions of the Law No. 9901, of	Neni 33 Fuqia e akteve Të gjitha çështjet për të cilat Statuti nuk i parashikon ose nuk i rregullon në mënyrë të posaçme do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901

14.04.2008 "For Merchants and Commercial Companies" – as amended, that determines the form of organization, functioning and supervision of the limited trade companies.

datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" – i ndryshuar, të cilat parashikojnë mënyrën e organizimit, funksionimit dhe kontrollit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

THE SOLE SHAREHOLDER/ORTAKU I VETËM

Mouala SULAIMAN

Mouala Sulaiman

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized 'M' followed by a long horizontal stroke that ends in a small loop.